

Në bazë të nenit 42 Ligjit për Arsim të Mesëm (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.6poj 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/2018, dhe Gazeta zyrtare e Republikës e Maqedonisë së Veriut nr. 229/2020), Ligji për arsim të mesëm profesional dhe trajnim Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013; 137/2013, 41/2014, 55/2016 и 64/2018 dhe Gazeta zyrtare e Republikës e Maqedonisë së Veriut nr.275/2019) dhe konkursi për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme publike në vitin shkollor 2024/2025 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Shkup, drejtori i SHMEK „Gostivar”- Gostivar shpall:

K O N K U R S

Për regjistrimin e nxënësve në vitin e I - (parë) në vitin shkollor 2024/2025.

I . N U M R I I N X Ë N Ë S V E

Në vitin e I - parë do të regjistrohen 200 nxënës në 8 paralele (75 nxënës në 3 paralele me mësim në gjuhën maqedone, 100 nxënës në 4 paralele me mësim në gjuhën shqipe dhe 25 nxënës 1 paralele me mësim në gjuhën turke) sipas plan programeve mësimore për:

- Me mësim në gjuhën maqedone

Profili arsimor	Numri i nxënësve	Numri i paraleleve	Minimum pikë
Teknik ekonomik kohëzgjatje prej katër vite *(bashkëpunim me PTTU Hinakom – EPB; PRECIZITET SHPKNJP; Benefit SHPKNJP; Brand Kom SHPKNJP; Viktorana SHPKNJP; Viktorija-Bob SHPK; Partner CO; ARS – PROM SHPK; Tamana Kom; Mona SHPKNJP; Smart Kont SHPKNJP; Azhurnim Plus SHPKNJP)	25	1	60
Administrator biznesi / Teknik për e-tregëti dhe marketing digjital kohëzgjatje prej katër vite *(bashkëpunim me Montenegro SHPK)	25	1	60
Teknik hotelerik kohëzgjatje prej katër vite *(bashkëpunim me SHTPH Albis)	25	1	45

- **Me mësim në gjuhën shqipe**

Profili arsimor	Numri i nxënësve	Numri i paraleleve	Minimum pikë
Teknik ekonomik kohëzgjatje prej katër vite *(bashkëpunim me Finance 21 dhe Eurofinance; Bilans Konsalting Office SHPKNJP; Selestina Konsalting SHPKNJP)	25	1	60
Teknik juridik kohëzgjatje prej katër vite *(bashkëpunim me Komunën e Gostivarit)	25	1	60
Administrator biznesi / Teknik për e-tregëti dhe marketing digjital kohëzgjatje prej katër vite *(bashkëpunim me Montenegro SHPK)	25	1	60
Teknik hotelerik kohëzgjatje prej katër vite *(bashkëpunim me Sydney Terrace)	25	1	45

- **Me mësim në gjuhën turke**

Profili arsimor	Numri i nxënësve	Numri i paraleleve	Minimum pikë
Teknik ekonomik kohëzgjatje prej katër vite *(bashkëpunim me Inter Impeks SHPK; Antep Bakllava; Nomino Led SHPKNJP; Resolutions Finance Konsalting SHPKNJP)	25	1	60

II. KUSHTET PËR REGJISTRIM TË NXËNËSVE

Regjistrimi i nxënësve në shkollën e mesme ekonomike komunale “Gostivar” - Gostivar për vitin shkollor 2024/2025 do të realizohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me Ligjin për arsim të mesëm, Ligji për arsim të mesëm profesional dhe trajnim dhe shpalljen e publikuar nga Ministria e arsimit dhe shkencës Shkup.

Për pjesëtarët e bashkësive etnike që e ndjekin mësimin në gjuhën që është ndryshe nga gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik, mësimi në shkollat e mesme publike realizohet në gjuhën dhe shkrimin e bashkësisë përkatëse.

Kushtet për regjistrimin e nxënësve janë:

- Të kenë të mbaruar arsimin fillor;
- Të mos jenë më të vjetër se 17 vjet;
- Të përcaktohen për njërin nga plan programet
- Të plotësojnë kriteret e kësaj Shpalljeje.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Për vitin e I (parë) gjatë aplikimit, nxënësit duhet të sjellin dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimi për regjistrim (aplikimi për regjistrim përgatitet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit);
- Dëftesa origjinale prej klasës VI deri në klasën IX;
- Diplomë të fituar (nëse posedon për vendin e I-rë, II-të dhe III-tretë), në gara ndërkombëtare dhe shtetërore (nga gjuha amtare, gjuhë e huaj, dhe lëndë mësimore me rëndësi për drejtimin përkatësisht për lëminë zgjedhore);
- Certifikatë të lindjes (pa marrë parasysh datën e dhënies);

IV. AFATET E KONKURSIT

Për vitin e I (parë).

Konkurrimi dhe regjistrimi i nxënësve do të realizohet në afatin e qershorit me dy paraqitje.

Konkurrimi i nxënësve do të bëhet përmes aplikimit elektronik, përmes linkut në portalin për shërbime elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës <https://e-uslugi.mon.gov.mk> me paraqitje speciale për nxënësit e shkollave të mesme përmes llogarive të tyre të përdoruesve të Schools.mk.

Paraqitja e parë elektronike e nxënësve do të bëhet prej 20 qershor deri 25 qershor 2024, deri në orën 15:00.

Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkollë nga ana e nxënësit, gjegjësisht prindit /kujdestarit do të bëhet më datë 20, 21 dhe 24 qershor 2024 nga ora 07:00 deri në orën 17:00 dhe më 25 qershor 2024 nga ora 07:00 deri në orën 15:00.

Ranglista përfundimtare me rezultatet nga regjistrimi dhe vendet e lira do të publikohen më 26 qershor 2024, më së voni deri në ora 09:00 në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe në faqen zyrtare të shkollës.

Testimi kualifikues do të organizohet në shkollat për arsim të mesëm më 28 qershor 2024, ndërsa renditja përfundimtare me rezultatet do të publikohet më 28 qershor 2024 në tabelën e shpalljeve të shkollës.

Paraqitja e dytë elektronike e nxënësve do të realizohet prej më 01 korrik - 02 korrik 2024 deri në orën 15:00.

Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkollë nga ana e nxënësit, gjegjësisht prindit /kujdestarit do të bëhet më datën 01 korrik 2024 nga ora 07:00 deri në orën 17:00 dhe më 02 korrik 2024 nga ora 07:00 deri në orën 15:00.

Renditja e listës përfundimtare me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira do të publikohen më 03 korrik 2024, më së voni deri në ora 09:00 në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe në faqen zyrtare të shkollës.

Testimi kualifikues do të organizohet në shkollat për arsim të mesëm më 05 korrik 2024 në vend publik të shkollës, kurse ranglista përfundimtare me rezultatet do të shpallet më 05 korrik 2024 në tabelën e shpalljeve të shkollës.

Nxënësit të cilët dërgohen në riprovime, provime të vitit, provim për avancim më të shpejtë mund të regjistrohen në shkollë në qoftë se do të mbeten vende të lira pas afatit të qershorit.

Regjistrimi i nxënësve do të bëhet më 21 gusht 2024 prej ora 00:00 deri në ora 15:00.

Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkollë nga ana e nxënësit, gjegjësisht prindit /kujdestarit do të bëhet më datën 21 gusht 2024 nga ora 07:00 deri në orën 17:00.

Lista përfundimtare ranguese me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira do të publikohen më 22 gusht 2024, më së voni deri në ora 12:00 në tabelën e shpalljeve të shkollës.

Pas publikimit të listës ranguese përfundimtare me rezultatet e regjistrimit, nxënësit që nuk janë regjistruar në SHMEK "Gostivar" - Gostivar, janë të detyruar të marrin të gjithë dokumentacionin e dorëzuar gjatë paraqitjes në SHMEK "Gostivar" - Gostivar në afat prej 24 orëve, ndërsa SHMEK "Gostivar" - Gostivar është e obliguar t'ua kthejë të gjithë dokumentacionin nxënësve në afat prej 24 orëve.

V. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Kriteret për zgjedhjen e nxënësve janë:

- Sukses mesatar i nxënësve nga klasa VI - IX;
- Suksesi mesatar i nxënësit i arritur në katër lëndë (gjuhë amtare, gjuhë të huaj dhe dy lëndë që janë me rëndësi për drejtimin Matematikë dhe Histori);
- Diploma të fituara për vendin (I, II dhe III), në gara ndërkombëtare dhe shtetërore;
- Diploma të fituara për vendin (I, II dhe III), në gara ndërkombëtare dhe shtetërore nga gjuha amtare, gjuhë të huaj dhe lëndë mësimore, të cilat janë të rëndësishme për drejtimin, respektivisht lëmin e zgjedhur);
- Vlera mesatare nga pikët e fituara për sjelljen nga klasa e VI deri në klasën IX.

Arsimi i mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore përfshin nxënësit sipas llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar

Nxënësit nga komuniteti etnik rom mund të regjistrohen në një shkollë të mesme publike të caktuar nëse kanë deri në 10% më pak pikë sesa numri i pikëve të parashikuara në Konkurs për programet mësimore përkatëse dhe nëse plotësojnë kriteret shtesë për testin e njohurive dhe aftësive në shkollën përkatëse.

Transporti dhe akomodimi i nxënësve të cilët do të regjistrohen në vitin e parë në shkollat e mesme publike, nuk do të sigurohet nëse lloji i zgjedhur arsimor (profesioni ose drejtimi) ekziston në komunën, përkatësisht rajonin nga vjen.

Në shkollë ku do të paraqiten numër më i madh i nxënësve nga ai i planifikuar me të njëjtët pikë të grumbulluara, do të organizohet test kualifikues nga lëndët me rëndësi për drejtimin (gjuhë amtare dhe matematikë).

Për suksesin mesatar prej kl. VI deri në kl. IX nxënësi mundet të fitojë më së shumti 50 pikë (suksesi i përgjithshëm prej kl. VI deri në kl. IX mbledhet, ndahet në katër dhe i njëjti shumëzohet me koeficientin 10).

Për suksesin mesatar nga katër lëndë mësimore të propozuara (dy lëndë mësimore të obligueshme për të gjithë llojet e arsimit (gjuhë amtare dhe gjuhë e huaj) dhe dy lëndë që janë me rëndësi për drejtimin matematikë dhe histori), nxënësi mundet të fitojë më së shumti 20 pikë (5 pikë për çdo lëndë).

Për vende të fituara nga gara ndërkombëtare dhe shtetërore nxënësi mund të fitojë më së shumti 5 pikë. (për vend të fituar në gara ndërkombëtare: 5 pikë, ndërsa për vend të fituar në gara shtetërore 3 pikë për vendin I-rë, 2 pikë për vendin e II-të, dhe 1 pikë për vendin e III-të). Nxënësit i vlerësohet vetëm një diplomë që i sjell më shumë pikë.

Për vlerësim mesatar nga pikët për sjellje nga VI - IX nxënësi mund të fitojë më së shumti 5 pikë. (Sjellje shembullore vlerësohet 5 pikë, sjellje e mirë vlerësohet 3 pikë dhe sjellje e pakënaqshme vlerësohet 0 pikë. Vlera mesatare është tërësi e pikëve për sjellje nga klasa VI - IX pjesëtuar me 4).

Nxënësi në bazë të gjithë kriterëve të parapara me këtë shpallje mund të fitoj më së tepërmi 80 pikë.

Numri i caktuar minimal i pikëve për paraqitjen e parë, është pjesë përbërëse e këtij Konkursi.

Shkollat për paraqitjen e dytë në afatin e qershorit mund të zvogëlojnë numrin e përcaktuar në pikët minimale të përcaktuara në Konkursin, më së shumti 10 pikë, përveç se për gjimnaz, drejtimin ekonomi - juridik dhe tregti dhe drejtimi shëndetësi.

Shkollat janë të obliguara që me Konkurs intern për paraqitjen e dytë përkatësisht paraqitjen e tretë të theksojnë minimumin e pikave të përcaktuara me të cilat nxënësit mund të konkurrojnë për regjistrim në planin dhe programin e caktuar mësimor.

Për nxënësit të cilët kanë mbaruar klasën e nëntë në Republikën e Maqedonisë së Veriut , ndërsa një, dy apo tre klasë (VI,VII apo VIII) kanë përfunduar jashtë vendit, për ato klasë do të merret sukcesi nga klasa e nëntë dhe do të vlejnjë të gjitha kriteret e njëjta të lartë përmendura gjatë përzgjedhjes së nxënësve.

Personat të cilët kanë mbaruar klasën e nëntë jashtë vendit mund të regjistrohet në këtë shkollë nëse e ka dëftesën e nostifikuar që ka mbaruar jashtë shtetit.

VI. ZGJEDHJA DHE REGJISTRIMI I NXËNËSVE DHE FORMIMI I PARALELEVE

Zgjedhja dhe regjistrimi i nxënësve bëhet me plan dhe program në bazë të së cilës është përcaktuar nxënësi dhe në bazë të pikëve të përgjithshme të cilat llogariten veç e veç për çdo lëndë.

Zgjedhjen dhe regjistrimin e nxënësve e bën Komisioni, i cili e shpall vendimin bashkë me rang listën në tabelën e shpalljeve dhe vendos për kundërshtimet e nxënësve nga rang lista përfundimtare në afat prej 12 orëve .

Gostivar, 05.04.2024

SHMEK „Gostivar” - Gostivar
u.d.Drejtor

Mihajlo Gjinovski